



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 7 dhe neni 76 paragrafi 2 alinea 2 nga Ligji për parandalim të Korrupsionit dhe konfliktit të interesave („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“, numër 12 / 2019) neni 40 dhe 41 të Rregullores për punë të Komisionit shtetërorë për parandalimin e korrupsionit, duke vepruar sipas një denoncimi nga një denoncues i njohur për dyshimë për paligjëshmëri dhe shkelje në procesin zgjedhorë dhe kampanjën zgjedhore në zgjedhjet Presidenciale dhe Lokale në zgjedhjet e vitit 2019, në seancën e 45-të e mbajtur me datë 29 dhjetorë të vitit 2020, Komisioni Shtetëror për parandalimin e korrupsionit sjellë vijim

## VENDIM

Procedura për lëndën me numër 12-2591 nga viti 2019, e formuar sipas denoncimit nr. 12-2591/1 nga data 03.05.2019 e dorëzuar nga denoncues i njohur për dyshimë për paligjëshmëri dhe shkelje në procesin zgjedhorë dhe kampanjën zgjedhore në zgjedhjet Presidenciale dhe Lokale në zgjedhjet e vitit 2019, **NDËRPRITET.**

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesit, Komisioni shtetërorë për parandalimin e korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm kompetent në lëndë me nr. 12-2591, në rastin e lëndës është arritur efekti nga qasja kompetente e KSHPK-së dhe nga ana e organit kompetent gjyqësor është dhënë gjykim me të cilin kryersi i shkeljes është shpallur fajtorë dhe i është shqiptuar sanksioni për shkelje – paralajmrim.

Lënda me nr. 12-2591 nga viti 2019 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dërgohet Vendimi i KSHPK-së me sqarim.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim, në formë të depersonalizuar, të publikohet në web faqen e KSHPK-së në afat prej 5 (pesë) ditësh na sjellja e këtij vendimi.

## Sqarim –shpjegim

Procedura për lëndën 12-2591 të vitit 2019 e formuar në bazë të denoncimit me nr. 12-2591/1 të datës 03.05.2019, është dorëzuar në Komisionin shtetërorë për parandalimin e korrupsionit nga denoncues i njohur për dyshimë për paligjëshmëri dhe shkelje në procesin zgjedhorë dhe kampanjën zgjedhore në zgjedhjet Presidenciale dhe Lokale në zgjedhjet e vitit 2019, denoncimin i pranuar përmbante akuza drejtuar personit udhëheqës në institucion shtetërorë për veprim në kundërshtim me detyrat nga neni 8-të nga Ligji për zgjedhje dhe nga neni 34, paragrafi 1 alinea 3 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesit, respektivisht për Vendimin për ndërprerë të mardhënies së punës në emër të denoncuesit të sjellur nga ana e drejtorit të Agjencionit

për ..... dhe ....., pasë ditës kur është sjellur Vendimi për shpalljen e Zgjedhjeve Presidenciale në RMV gjegjësisht me datën 04.03.2019, gjë që është në kundërshtim me dispozitat e përmendura.

Në raport me denoncimin e parashtruar është vepruar nga ana e KSHPK-së e cila me veprimin kompetent të sajë dhe në pajtueshmëri me nenin 22, paragrafi 1, nenin 23, paragrafi 1 dhe nenin 24, paragrafi 3, kurse në lidhje me nenin 34, paragrafi 1, alineja 3 dhe neni 33 paragrafi 7 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesit („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë „, numer 12 / 2019 ) dhe neni 179, paragrafi 1 nga Ligji për zgjedhje („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë „, numer 40/ 6, 136/08, 148/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 54/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19), në senacën e sajë të 14-të të mbajtur me datën 06.05.2019, është sjellur Vendimi me numër 12-2591/4 nga data 08.05.2019 i cili thotë:

„Dyshimet për paligjshmëri dhe dhe shkelje në procesin e zgjedhjeve dhe në kampanjën zgjedhore në Zgjedhjet Presidenciale dhe Lokale te vitit 2019 , të përmenduar në lëndën me numër 12-2591/1 nga data 05.03.2019 , janë të bazuara.

Të udhëhiqet procedur për shkelje kundër personit bartës të funksionit publikë – drejtorë i Agjensionit për.....dhe ....., për shqiptimin e dënimit për shkelje në pajtueshmëri Me nenin 179 –të nga Ligji për zgjedhje, përshkakë të veprimit në kundërshtim me dispozitat e nenit 8-të të Ligjit për zgjedhje si dhe me nenin 34, paragrafi 1 alineja 3, nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesit.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dërgohet njoftim me shkrim për veprimin dhe përfundimin e sjellur nga ana e KSHPK-së.,,

Duke patur parasyshë rastin e lëndës, është konstatuar shkelje e dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesit dhe Ligjit për Zgjedhje, e cila me të njëjtin ligjë është ciluar si shkelje, nga ana e personit të autorizuar zyrtarë në KSHPK i autorizuar për të ndërmarur veprime në procedurën për zgjidhje, për dhënien e urdhërit të pagesës për shkelje dhe për paraqitjen e kërkesës për udhëheqjen e procedurës për shkelje, raport i formuluar dhe e nënshkruar për shkelje e cila është kontaktuar, ndërsa në të njëjtën kohë kryersit të shkeljes i është propozuar njëra prej procedurave të përshpejtuara, - procedura për shqiptimin e urdhërit të pagesës , dhe i është dhënë një urdhër pagese.

Nga ana e kryersit të shkeljes, në kohën e paraparë nukë është vepruar ndaj urdhërit të pagesës të lëshuar nga KSHPK , si dhe nuk është paguar dënimi në kohën e paraparë ligjore dhe nga ana e tij nuk është dorëzuar se dënimi është paguar, me cka personi i autorizuar zyrtarë deri tek Gjyqi kompetent, ka parashtruar Kërkesë për iniciimin e procedurës për shkelje me numër:12-2591/8 nga data 26.06.2019.

Pas parashtrimit të kërkesës nga ana e KSHPK-së është formuar lëndë nga Gjykata themelore penale në bazë të së cilës janë mbajtur dy senaca ndëgjimore në datën 19.11.2019 dhe në 03.12.2019, në të cilat ka prezantuar edhe përfaqësuesi i autorizuar i KSHPK-së , dhe është sjellur Aktgjykimi XVIII PRK- 0.....2019 nga data 05.12.2019, me të cilën i akuzuari është shpallur fajtorë, në rport me veprimtarit e përmendura të kryera nga ana e tijë në cilësin e personit udhëheqës në institucionin

shtetërorë me të cilën ka kryer shkelje nga neni 8-të nga Ligji për zgjedhje dhe nga neni 34, paragrafi 1 alineja 3 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesit, i dënueshëm nga neni 179, paragrafi 1 nga Ligji për zgjedhje, në pajtueshmëri me nenin 16, 24, 34, 35, 117, paragrafi 1, dhe neni 118 paragrafi 1 nga Ligji për shkelje (kundërvajtje), nga ana e Gjykatës i është shqiptuar Sanksion për shkelje – PARALAJMRIM. Gjithashtu i akuzuari ka qenë i detyruar ti kompenzojë harxhimet e procedurës dhe ti paguaj të njëjtat në llogarinë e Gjykatës penale themelore në Shkup.

Duke patur parasyshë gjithë atë që është përmendur më lartë, KSHPK konstaton se në lidhje me lëndën është vepruar nga organi kompetent gjyqësorë – Gjykata penale themelore në Shkup, e cila ka sjellë aktvendimin me të cilin kryersi i shkeljes si person i akuzuar është shpallur fajtorë dhe i është shqiptuar masa sanksion për shkelje – PARALAJMRIM, me të cilën është arritur efektë nga veprimi kompetent i KSHPK-së në këtë lëndë. Duke patur parasysh një gjendje të këtillë faktike, KSHPK vleron se në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konflikteve të interesit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm, procedura për lëndën ndërpritet, lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke patur parasyshë të lartëpërmendurën Komisioni Shtetërorë për parandalimin e korrupsionit vendose në bazë të dispozitave të këtij vendimi.

### **E vendosur me datën 29 dhjetorë 2020 me nr.12-345/2**

Dërguar deri tek Arkivi, parashtruesi  
Me përfundim të KSHPK,  
Punoi; J.C., këshilltarë  
Miratoi: S.P.D., antar i KSHPK

KOMISIONI SHTETËRORË PËR  
PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
Zëvendës-kryetarë: Sofka Pejovska Dojçinovska